



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. 07-370/01-VJ56106/26

Datë: 21.09.2026

Në bazë të nenit 23 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 11 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore, Komuna e Mitrovicës së Jugut, shpall:

K O N K U R S

(për përzgjedhjen e agjencisë së udhëtimit të nxënësve për ekskursion jashtë vendit - Shqipëri)

I. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim të agjencioneve turistike:

- ☐ Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- ☐ Licenca e Agjencionit turistik;
- ☐ Çertifikata e agjencionit transportues;
- ☐ Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore rrugore;
- ☐ Agjencioni duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollave;
- ☐ Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasëve të autobusëve;
- ☐ Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- ☐ Autobusët duhet të jenë komfor dhe me klimë;
- ☐ Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së agjencioneve turistike:

Përzgjedhja e agjencioneve turistike do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016, dhe sipas kërkesave të shkollave.

III. Shkollat të cilat kanë bërë kërkesë për ekskursion janë:

- SHMLM "Dr.Xheladin Deda" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (270-300)
Prej datës 30.09.2026 deri 04.10.2026 vendi Shqipëri;
- SHMLT "Arkitekt Sinani" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (90-130)
Prej datës 30.09.2026 deri 04.10.2026 vendi Shqipëri;

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga data e publikimit të konkursit më 21.09.2026 deri më datën 27.09.2026 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit;

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni.
Konkursi publikohet edhe në ueb-faqe zyrtare të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/>

Shefki BEGU

Drejtore
Drejtoria Komunale e Arsimit

